



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
-KOMISIONI I KONKURENCES-**

---

**V E N D I M**

**Nr. 87 Datë 22. 09.2008**

**Mbi**

**Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Deutsche Telekom AG në shoqërinë Hellenic Telecommunication Organization SA dhe indirekt në shoqërinë AMC SHA**

**Komisioni i Konkurrencës** me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Z. Lush Perpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës **22. 09.2008**, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm në shoqërinë Hellenic Telecommunication Organization SA(OTE) nga shoqëria Deutsche Telekom AG

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, Kreu IV "Procedurat për kontrollin e përqendrimeve" nenet 53-56, Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve", Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit" dhe Aneksi I-Formulari "Për njoftimin e Përqendrimit".

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit, në lidhje me transaksionin e njoftuar,

**V Ë R E N S E:**

1. Njoftimi i përqendrimit me objekt përfutimin e kontrollit nga shoqëria Deutsche Telekom AG (këtu e si vijon DT), në shoqërinë Hellenic

Telecommunication Organization SA, është depozituar në Autoritetin e Konkurrencës në datën 21 Maj 2008, brenda afatit ligjor.

2. Transaksioni i njoftuar paraqitet si përfitim kontrolli i drejtëpërdrejtë i DT në O.T.E nëpërmjet zotërimit të 25%+1 të aksioneve.
3. Në Shqipëri, DT fiton kontroll të tërthortë mbi shoqërinë e telefonisë së lëvizshme, Albanian Mobile Communication (AMC ShA), ku filiali i zotëruar 100% nga OTE, Cosmote Group zotëron 82% të aksioneve.
4. Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 2, 10 dhe 12, pika 1 të Ligjit, e konsideroi këtë transaksion si objekt të shqyrtimit nga ana e tij.

### I. Palët e përfshira

5. **Deutsche Telekom AG**, në cilësinë e **blerësit**, është shoqëri aksionere, e cila funksionon sipas legjislacionit federal gjerman, regjistruar në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Bonit në Janar 1995. me seli në adresën Friedrich-Ebert-Allee 140, 53113, Bonn, Gjermani.
6. **Hellenic Telecommunication Organization SA**, në cilësinë e **shitësit** është shoqëri anonime, që funksionon sipas legjislacionit grek, themeluar në vitin 1949, me seli në adresën 99 Kifissias Avenue, Amaroussion 15181, Athinë, Greqi.
7. OTE shtrihet në Europën Juglindore, me anë të shoqërive bija dhe të kontrolluara, me një pjesëmarrje domethënëse në telefoninë fikse (Greqi, Serbi dhe Rumani) dhe në telefoninë e lëvizshme në Greqi, Maqedoni, Rumani, Bullgari dhe Shqipëri.

#### I.1. Palë të lidhura indirekt

8. **Cosmote SA**<sup>(1)</sup>, është shoqëria kryesore e grupit Cosmote që zotërohet 100 % nga OTE. Cosmote është e pranishme në tregun shqiptar nëpërmjet kontrollit të 82 % të aksioneve të AMC SHA dhe gjithashtu është e pranishme në tregjet e rajonit si në Bullgari ku zotëron 100 % Globul, Rumani ku zotëron 70 % të Cosmote 70% dhe Maqedoni me Cosmofon ku zotëron 100% të aksioneve.
9. **AMC SHA**, është shoqëri anonime, që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar me numër rregjistri 12910, datë 27.11.1995, me seli

---

<sup>1</sup> Filiali i zotëruar 100% nga OTE.

në Tiranë, që ushtron veprimtarinë në fushën e telekomunikacionit të lëvizshme.

10. Pjesa e tregut që zë AMC sha në tregun e brendshëm për produktet e telefonisë së lëvizshme është 51.5%<sup>2</sup>. Aktualisht, AMC ka rreth 1.195.000 abonentë<sup>3</sup> dhe ofron shërbimet në të gjithë vendin me anë të platformave GSM dhe GPRS.

## II. Transaksioni

11. Nëpërmjet marrëveshjeve të datës 14 Maj 2008, të lidhura ndërmjet shoqërisë DT dhe Republikës Greke, DT nga blerja e aksioneve dhe e të drejtës së votës, do të ushtrojë kontrollin influencues në manaxhimin e shoqërisë OTE .
12. Pas realizimit të këtij transaksioni, struktura e pronësisë dhe e kontrollit do të jetë:
- a) DT zotërues i 25% plus 1 aksion;
  - b) Republika Greke, zotërues i 25% plus 1 aksion;
  - c) Investues Ndërkombëtar Institucional, zotërues të 48% të kapitalit aksionar.
13. Pronësia e aksioneve nga të dy palët pjesëmarrëse në transaksion të marra së bashku do të jetë 50% të kapitalit aksionar. Në bazë të Marrëveshjes të Aksionerëve të nënshkruar nga palët në datën 14 Maj totali i të drejtës së votës në Asamblenë e Përgjithshme të aksionerëve do jetë 50%+ 2 të drejta vote. Në këtë kontekst, DT dhe Republika Greke do të bashkëpunojnë (drejtim i përbashkët) në lidhje me politikën e biznesit të OTE-së, në bazë të kushteve të përcaktuara në nenet 4- 7 të marrëveshjes së aksionerëve.
14. DT përfton kontrollin e vetëm në OTE **jo nga nga blerja e një “pakicë kontrolli”**, por nga blerja e të drejtës së votës, që përfshin: të drejta në vendim marrje, si rezultat i së cilës DT-së i krijohet mundësia për të ushtruar një ndikim vendimtar mbi veprimtarinë tregtare në lidhje me përbërjen ose vendimet e organeve drejtuese të OTE-s, si dhe mundësia për të orientuar politikën tregtare të saj (marrja e vendimeve mbi prodhimin, çmimet, shitjet, etj).

---

<sup>2</sup> Sipas formularit të njoftimit dhe vendimin nr 59 të Komisionit të Konkurrencës

<sup>3</sup> Sipas formularit të njoftimit

15. DT zotëron një të drejtë vote preferenciale , që do të thotë që në rast balotazhi, DT ka të drejtën e vendim marrjes lidhur me vendimet përfundimtare në Bordin Drejtues.
16. Ndërsa, e drejta e votës preferenciale që zotëron Republika Greke, përshin të drejtat e vetos të cilat kanë të bëjnë kryesisht me çështjet financiare, çështje të emrit, të markës, të juridiksionit etj por nuk i japin kësaj të fundit influencë vendimtare mbi OTE, që do të thotë që OTE SA gëzon kontroll të vetëm negativ.
17. Me realizimin e këtij transaksioni, DT synon:
- Të përmirësojë konkurrueshmërinë në tregun kombëtar;
  - Të zgjerojë tregun e komunikimit të telefonisë, kryesisht të telefonisë së lëvizshme;
  - Të rrisë shërbimet e internetit në telefoninë e lëvizshme;
18. Ndërsa OTE, do të përfitojë nga ekspertiza teknike e partnerit strategjik DT dhe njëkohësisht duke shfrytëzuar maksimalisht sinergjitë e grupit do të përmirësojë edhe marzhin EBITDA.

#### **IV. Xhiro**

19. Xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në tregun ndërkombëtar për vitin 2007 është XXXX miliard lekë, e ndarë:
- DT : XXX miliard €uro = XXX miliard lekë;
  - OTE : XXX milion €uro = XXX miliard lekë.
20. Xhiro totale në tregun e brendshëm për vitin 2007, realizuar nga AMC ShA është: XXX miliard lekë.

#### **V. TREGU PËRKATËS :**

##### **V.I. Tregu Përkatës i Produktit**

21. Në përputhje me vendimet e mëparëshme të Komisionit European dhe praktikat standarte rregullatore të përdorura për sigurimin e shërbimeve të telekomunikacionit, si dhe sipas përcaktimit të palëve pjesëmarrëse në transaksion, treg përkatës do të konsiderohet tregu që përfshin produktet/shërbimet e industrisë së telekomunikacionit, të ndara në produktet e telefonisë së lëvizshme dhe telefonisë fikse.
22. Palët pjesëmarrëse, ofrojnë shërbime në të dy nëndarjet e tregut të telefonisë.
- DT siguron një gamë të gjërë të shërbimeve të telekomunikacionit dhe teknologjisë informatike në nivel ndërkombëtar, duke operuar në

tre segmente: Mobile Communications, Broadband/Fixed Network and Business Customers, që përfshijnë: ofrimin e shërbimeve të zërit (VoIP), të të dhënave, të sms-ve, mms, të internetit (ISP), broadband, shërbime roaming, shërbime me vlerë të shtuar, komunikime satelitore dhe ëireless, etj.

b- OTE siguron një gamë të gjërë të produkteve dhe shërbimeve të telekomunikacionit, duke përfshirë këtu thirrjet lokale, në distancë të largët dhe ato ndërkombëtare; komunikimin e të dhënave me shpejtësi të lartë, shërbimet ADSL (asymmetric digital subscriber line), shërbimin e transferimit të të dhënave broadband, shërbime të rrjetit brenda dhe jashtë Greqisë, shërbime të telefonisë së lëvizshme (ëireless dhe komunikime satelitore), shërbime të klientit etj.

**23.** Produktet e tregtuara nga të dy palët pjesëmarrëse në transaksion, në kuptim të nëndarjes së industrisë së telekomunikacionit, janë të njëjtë dhe të zëvendësueshme si nga ana e ofertës ashtu edhe nga ana e kërkesës.

## **V. II. Tregu Gjeografik:**

Nisur nga fakti që rrjetet prirën të kenë një zonë zgjerimi/mbulimi kombëtare, një kuadër rregullator dhe ligjor të unifikuar, licenca kombëtare, si dhe klientë që mund të këmbëjnë me lehtësi ofruesin e shërbimit, duke plotësuar kërkesat e tyre në mënyrë më ekonomike dhe më të lehtë, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu kombëtar <sup>(4)</sup>ku përfshin të gjitha shërbimet e telefonisë fikse dhe të lëvizshme të ofruara nga palët pjesëmarrëse në transaksion.

**24.** Por, meqënëse në tregun e brendshëm, Shqipëri:

- I. DT nuk është prezente as direkt dhe as në mënyrë të tërthortë për asnjë nga produktet/shërbimet e tij ; dhe
- II. OTE është aktive në mënyrë të tërthortë në tregun e produktit vetëm për shërbimet e telefonisë së lëvizshme, nëpërmjet shoqërisë AMC Sha.

**25.** Tregu gjeografik do konsiderohet Territori i Shqipërisë.

## **VI. Analiza e Konkurrencës**

**26.** Palët pjesëmarrëse operojnë në të njëjtin nivel tregu produkti në ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit, përfshirë këtu shërbimet fikse dhe të lëvizshme, por në zona gjeografike të ndryshme.

---

<sup>4</sup> Commission Decision of April 26, 2006, Case No. COMP/M.3916 - T-Mobile Austria/telemobil; Commission Decision of May 25, 2005, Case No COMP/M.3776 – Vodafone/Oskar Mobile and Commission Decision of June 10, 2005, Case No. COMP/M.3806 - Telefónica/Cesky Telecom

**27.** Blerësi, (DT) është operator me fuqi të ndjeshme jo vetëm në tregun gjerman të telekomunikacioneve, por edhe në disa tregje të tjera ku operon nëpërmjet filialeve të saj.

**28.** Shitësi OTE ka fuqi të konsiderueshme tregu në:

I- Greqi, nëpërmjet zotërimit 100% të filialeve (bija të saj), (a) Oteglobes - në shërbime e telefonisë fikse, që zë më shumë se 50% të tregut dhe b- Cosmote - shërbime të telefonisë së lëvizshme, që kap 38.6 % të tregut). Konkurrentët kryesorë të OTE në Greqi janë: TIM Hellas që zë (21% të tregut) dhe Vodafone Group PLC (34.7%).

II- Në mënyrë të tërthortë në tregjet e telekomunikacionit në Ballkan nëpërmjet pjesëmarrjes në kapitalin aksionar, si:

- a) Rumani, 54% në shoqërinë RomTelekom për shërbime telekomunikacioni fikse dhe 70% në shoqërinë Cosmote Rumani për shërbime telekomunikacioni të lëvizshme),
- b) Bullgari (Cosmote-Globul 100%), për shërb.tel. së lëvizshme
- c) Shqipëri, (AMC 82%); “ “ “
- d) Maqedoni (Cosmofon 100%) “ “ “
- e) Serbi (Telekom Serbia 20%, për shërbime fikse)

**29.** Përfitimi i kontrollit nga DT në shoqërinë O.T.E zgjeron rritjen e konsoliduar të DT, veçanërisht në tregun e telefonisë së lëvizshme të Europës Juglindore, (me përjashtim të tregut në Slloveni dhe Kosovë). Mbas realizimit të transaksionit sinergjitë e reja priten të gjenerojnë një vlerë neto rreth 2 miliard Euro.

**30.** Gjithashtu, forcimi i suksesshëm i DT në tregun evropian të telekomunikacionit, duke nxitur dhe zhvilluar inovacionet, teknologjinë dhe shërbimin ndaj klientit, pritet të rrisë konkurrencën dhe për rrjedhim edhe eficiencën në përgjithësi në tregun e telekomunikacionit dhe në veçanti në atë pjesë të tregut të zotëruar më parë nga OTE.

## **VI. 1. Analiza e konkurrencës në tregun e brendshëm**

**31.** OTE është prezente në tregun e brendshëm, indirekt, për shërbimet e telefonisë së lëvizshme, nëpërmjet kontrollit të filialit kryesor Cosmote, tek shoqëria AMC ShA, që gëzon një pozicion dominant në tregun e telefonisë së lëvizshme dhe në veçanti në tregun e shërbimit me kartë të parapaguar.

- 32.** Pjesa e tregut që zë AMC Sha në tregun e brendshëm për produktet e telefonisë së lëvizshme është 51.5%. Konkurrenti i vetëm i AMC, për vitin 2007 është shoqëria Vodafon Albania me pjesë tregu 48.5%, e cila ofron të njëjtat shërbime.
- 33.** Sipas pikës nr. 51 të Vendimit Nr 59, datë 09.11.2007 të Komisionit të Konkurrencës, kompanitë AMC Sha dhe Vodafone Albania kanë pozitë dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme.
- 34.** ERT(sot AKEP), me Vendimet Nr. 396 dhe 397, të datës 18.9.2007 ka shpallur AMC Sha Operator me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT) për tregun e terminimit të thirrjeve dhe tregun e shërbimeve publike të lëvizshme.
- 35.** Operatori i tretë i telefonisë së lëvizshme Eagle Mobile sha, filial i zotëruar plotësisht nga shoqëria Albtelekom, ka filluar veprimtarinë e tij në mars 2008 dhe deri në qershor të vitit 2008, bazuar në numrin e abonentëve, zotëron një pjesë shumë të vogël tregu <sup>(5)</sup>.
- 36.** Me synim zgjerimin e tregut të telefonisë së lëvizshme dhe rritjen e konkurrencës potenciale, qeveria ka vendosur hapjen e procedurave për një license të katërt të telefonisë së lëvizshme.
- 37.** Transaksioni i synuar prek industrinë e telekomunikacionit, por realizimi i tij, nuk sjell mbivendosje të shërbimeve fikse apo të lëvizshme, mbasi palët pjesëmarrëse nuk kanë pjesëmarrje të kryqëzuar në tregjet gjeografike edhe për sa i përket kontrollit në filialet e tyre apo në shoqëri të tjera dhe nuk kanë klientë të përbashkët, pra nuk shkakton kufizim të konkurrencës.
- 38.** Transaksioni realizon një ndryshim në pronësinë e aksioneve në shoqërinë OTE, dhe nuk ndikon në përqindjen e pjesës tregut që zotëron indirekt kjo shoqëri në Shqipëri, si dhe nuk krijon mbivendosje në ofrimin e shërbimeve, për pasojë nuk forcon pozitën dominuese të AMC SHA.
- 39.** Transaksioni që realizon përfitimn e kontrollit influencues të operatorit strategjik DT në OTE, nëpërmjet ndryshimit të politikës së drejtimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacioneve, pritët të rrisë

---

<sup>5</sup> Sipas planit të biznesit të shoqërisë, “Eagle Mobile” për të kthyer nga një operator potencial në një operator real, synon të ngrejë rrjetin e vet duke konkurruar realisht me dy operatorët ekzistues në treg. Aktualisht Eagle mobile ka arritur shtrirjen që garanton mbulim cilësor të zonave të banuara dhe të gjitha rrugëve rajonale dhe kombëtare.

konkurrueshmërinë në tregun e telefonisë në përgjithësi dhe indirekt në veçanti, edhe në Shqipëri për telefoninë e lëvizshme.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të vetëm nga shoqëria Deutsche Telekom direkt në shoqërinë OTE në Greqi dhe indirekt në AMC ShA në Shqipëri nëpërmjet përftimit të kontrollit të 82 % të aksioneve.

### **KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Lush PERPALI**

(\_\_\_\_\_)  
**Zv/Kryetar**

**Servete GRUDA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita Milo (Lati)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R E**